

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE

Nr.BaPa: 08-1392/4
Data/Date: 21/12/2023
Shtojca/Docaci/Annex:



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira - Department Slobodnih Profesija -
Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.28/2023

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevci dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P.nr.383/2019, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Fadilete Hoxha- Blakçori, pala ankuese nga fshati , komuna e . dhe Përmbaruesi Privat, pas këshillimit dhe votimit me datë 15.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-28/2023 i datës 02.11.2023, si dhe ankesa e palës ankuese nga fshati , komuna e , e datës 23.10.2023 **si të pabazuara.**

II. Përmbaruesi Privat , si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , nuk është përgjegjës për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore P.nr.383/2019.

A r s y e t i m

Me datën 23.10.2023, pala ankuese ka parashtruar ankesë ndaj përmbaruesit, me pretendimin se përmbaruesi privat ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, duke e dëmtuar palën ankuese në vlerë prej 2000 eurosh, duke

Shkelje sipas palës ankuese është se përmbaruesi nuk i është referuar datave për të cilat është kërkuar borgji si dhe duke keqpërdorur edhe llogarinë bankare të palës ankuese ka inkasuar shumë prej 50 eurosh më tepër.

Me këto veprime sipas palës ankuese, përmbaruesi ka bërë shkelje ligjore, andaj i ka propozuar komisionit që të aprovohet ankesa e debitorit dhe të ndërmerren masa ndaj përmbaruesit privat.

Me datën 02.11.2023, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komision Raportin Përfundimtar ndaj përmbaruesit privat, lidhur me veprimet përmbarimore për këtë lëndë.

Përmbaruesi Privat, si në deklaratën e tij, ashtu edhe në seancën dëgjimore ka deklaruar se sa i përket pretendimit të palës ankuese, ato nuk qëndrojnë, sepse përmbaruesi ka vepruar bazuar në dispozitat ligjore.

Pala ankuese ka parashtruar prapësim në këtë lëndë dhe gjykata e ka refuzuar prapësimin, të cilin vendim të shkallës së parë e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit. Sipas përmbaruesit, ankesa më tepër ka ardhur për inate personale që pala ankuese ka krijuar me përmbaruesin.

Pala ankuese ka shlyer vullnetarisht obligimin ndaj kreditorit, ndërsa shumë prej 50 eurosh, pasi është bërë konstatimi i pagesës direkt në llogari të kreditorit nga vet debitori dhe nga ajo shumë prej 50 eurosh i është kthyer pjesa prej 26 eurosh në llogari të debitorit pasi është konfirmuar nga kreditori për përmbyllje të obligimit direkt në llogari të kreditorit.

Në seancën dëgjimore, pala ankuese ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë pretendimeve të parashtruara përmes ankesës dhe se shuma e tërhequr prej 50 eurosh më tepër është bërë nga ana e përmbaruesit.

Përmbaruesi privat në seancën dëgjimore në deklaratimet e cekura nga përfaqësuesi i palës ankuese, ka deklaruar se ka vepruar duke u bazuar në dokumentin përmbarimor që është fatura dhe librat afariste të kreditorit dhe pas njoftimit të kreditorit mbi përmbylljen e obligimit nga debitori, e ka kthyer pjesën e mbetur tek debitori në shumë prej 26 eurosh.

Pas seancës dëgjimore, dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar se në këtë rast Përmbaruesi Privat, nuk është përgjegjës për asnjërën nga shkeljet disiplinore të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së. Këtë konstatim komisioni e bazoi në dokumentin përmbarimor.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese lidhur me pagesën e më tepër të shumës për periudhën që është kërkuar në propozim, këtë pjesë e ka trajtuar gjykata sa i përket bazueshmërisë së dokumentit përmbarimor dhe këtyre pretendimeve.

Lidhur me shumë e inkasuar më tepër prej 50 eurosh, komisioni ka konstatuar se pala - debitori ka pasur kontratë për shlyerje të obligimit përmes llogarisë së përmbaruesit, por pasi një pjesë e obligimit është kryer direkt në llogari të kreditorit, organi përmbarues pas marrjes së njoftimit nga kreditori, ka barazuar inkasimet dhe ka kthyer shumë e inkasur prej 26 eurosh.

Pasi komisioni nuk ka pasur ndonjë provë të tillë siç parashihet në pikën 2 të nenit 167 të LPDTS-së, e ka pasur të pamundur që të vlerësoj lidhur me faktin se a është ekzekutuar pengu konform dispozitave për ekzekutim gjyqësor të pengut.

Pretendimet e palës ankuese nuk janë provuar me provat që janë dorëzuar në shkresat e lëndës.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPL.nr.28/2023 datë 15.12.2023

Kryesuesja e Komisionit Disiplinor
Manushe Karaçi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.